



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 544/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçan, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në Qendrën e Votimit nr. 0101C në shkollën e mesme “Vëllezërit Frashëri” pretendohet se kandidati për asamble komunale dhe njëherit drejtori për buxhet e financa në komunën e Deçanit Agron Demukaj ka frekuentuar në këtë qendër i pajisur me begjë të falsifikuar nga ndonjë militant i AAK-së thuhet në pretendimet e ankuesit. Veprimi i tillë është në kundërshtim Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, kreu IX neni 54, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur, si provë fotografi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik LDK, nuk qëndrojnë ngase nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmitarë që mund të dëshmoj se Agron Demukaj, ka qëndruar gjatë në QV si dhe ka qenë i pajisur me begj të falsifikuar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar për të u administrua si provë relevante dhe bindëse, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 544/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.